



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 3819 Prot.

Fier, më 25.03.2026

Lënda: Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier.

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Fier

Prefektit të Qarkut Fier

Në mbështetje të nenit 53, pika 4 dhe nenit 56, pika 2, shkronja "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak Fier, e cila do të zhvillohet në sallën e këshillit **ditën e Martë, datë 31.03.2026, ora 13:30**, me këtë rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës.**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 27.02.2026.**
3. **Projekt – vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Shkurt 2026."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

4. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave (PBA) 2027-2029."

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

5. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Buxhetit Afatmesëm 2027-2029" të Bashkisë Fier.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

6. **Projekt – vendim:** "Për shtyrjen e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet ekonomike që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Fier për Vitin 2026"

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr. 3818

Fier në 25.03.2026

VENDIM NR. 3 DATË 25.03.2026

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit", Kreu 2, neni 22 "Kryesia e Këshillit" neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraprak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 31.03.2026 ora 13.30. Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraprak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

 **KRYESIA E KËSHILLIT**
1-Antoneta Çuhaj 2-Arben Çuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Marjus Voja

5-Krëshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika

7. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari të aktiveve, pasurisë të llojit ‘ndërtesë’ (Hlogaria ekonomike 212) të Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Fier”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

8. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e vijimit të procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. 5/89 zk. 8534 me sipërfaqje totale 1584 m² (tregu i fruta – perimeve, ndërtesë dy - katëshe) lagja “Kastriot” Fier, në pronësi të Bashkisë Fier”.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

9. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit ‘Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transmetimit të energjisë elektrike’ në pronat e Bashkisë Fier”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

10. **Projekt – vendim:** “Miratimin e ‘Planit të masave për mbrojtjen kundër zjarrit’ dhe ‘Planit të Veprimit’, për Bashkinë Fier, për vitin 2026.

Komisioni përgjegjës: “Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.”

11. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore në 2026-2028”, Bashkia Fier.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

12. **Projekt – vendim:** Për miratimin e pagesës për mbulimin e shpenzimeve të transportit mortor për të ndjerin Detlef Fertig, në vlerën prej 20,000 lekësh.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

13. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Qirjako Ferti në vlerën prej 84,000 lekësh.

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë Vendore, Financave, Buxhetit, Taksave, Tarifave, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqytjes Financiare.

- 14. Projekt – vendim:** “Për një ndryshim në VKB Nr. 14, datë 29.01.2026, ‘Për ngritjen e komisionit për trajtimin e kërkesave për ndihmë të menjëhershme dhe për riparim banesash’ pranë Bashkisë Fier.”

Komisioni përgjegjës: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Infrastrukturës dhe Strehimit.

- 15. Projekt – vendim:** “Për dhënien e titullit ‘Qytetar Nderi’ z. Miti Nushi dhe z. Lllazar Pove.”

Komisioni Përgjegjës: Komisioni i Arsimit, Sporteve, Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Turizmit, Dhënies së Titujve, Emërtimeve, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit European.

- 16. Diskutime dhe komente.**

Kryetar Këshilli
Antoneta Çunaj

